



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 qershor 2022  
Nr. ref.: RK 1998/22

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI104/21**

Parashtrues

**Kadri Veliu, Hatushe Veliu, Ariana Veliu, Alvin Veliu dhe Diana Veliu**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme  
E. Rev. nr. 427/2020 të 12 prillit 2021**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Kadri Veliu, Hatushe Veliu, Ariana Veliu, Alvin Veliu dhe Diana Veliu të gjithë nga Ferizaj, të cilët i përfaqëson Feride Ceka, avokate nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E. Rev. nr. 427/2020] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) të 12 prillit 2021 në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 4145/2015] e Gjykatës së Apelit të 27 prillit 2020 dhe Aktgjykimin [C. nr. 675/11] e Gjykatës Themelore në Ferizaj, (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) të 7 gushtit 2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit, sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 27 maj 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 4 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Selvete Gërxfhaliu-Krasniqi dhe Safet Hoxha, anëtarë.
7. Më 8 qershor 2021, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga përfaqësuesi që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për t'i përfaqësuar ata në procedurën në Gjykatë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 22 qershor 2021, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës e dorëzoi autorizimin e kërkuar në Gjykatë.
9. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-

Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

10. Më 12 maj 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 6 nëntor 2011, parashtruesit e kërkesës pësuan aksident trafiku të shkaktuar nga i siguruari i kompanisë së sigurimeve "Sigal" në Prishtinë në të cilin aksident trafiku, parashtruesi i kërkesës K.V., ka pësuar lëndime të rënda trupore.
12. Më 28 dhjetor 2011, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në Gjykatën Themelore në Ferizaj për kompensim të dëmit të shkaktuar nga i siguruari i kompanisë së sigurimeve „Sigal“.
13. Më 7 gusht 2015, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [C. nr. 675/11] pjesërisht aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës dhe obligoi kompaninë e sigurimeve "Sigal" që t'u paguajë parashtruesve të kërkesës, secilit individualisht, kompensimin në shumën e përgjithshme prej 62,881,63 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 12%, e cila është përcaktuar në pajtim me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia nr. 04/L-018 të 28 dhjetorit 2011, në pritje të pagesës përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore arsyetoi caktimin e kamatëvonesës prej 12% në bazë të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia nr. 04/L-018 (në tekstin e mëtejme: Ligji për sigurimin e detyrueshëm).
14. Në dispozitiv të aktgjyimit të Gjykatës Themelore thuhet,

***I APROVOHET*** pjesërisht kërkesë padia e paditësve Kadri Veliu, Hatushe Veliu, Veliu, Alvin Veliu dhe Diana Veliu nga fshati Slivove Komuna Ferizaj, si e bazuar.

***II OBLIGOHET*** e paditura KS "SIGAL", me seli në Prishtinë që paditësve në emër shpërblimit të dëmit të pësuar t'iu paguajë dhe atë:

- ***paditësit Kadri Veliu***

***1. Në emër të dëmit jo material***

- a. për dhimbje trupore-fizike shumën prej 7.500,00 €;
- b. për frikë të pësuar shumën prej 7.500,00 €;
- c. për shëmtim trupor shumën prej 3.500,00 €;
- d. zvogëlimin e aktivitetit jetësor shumën prej 16.000,00 €.

***2. Në emër të dëmit material;***

- a. për kujdes nga personi i tretë shumën prej 200,00 €
- b. për ushqimit të përforcuar shumën prej 300,00 €
- c. për rehabilitim-terapi fizikale shumën prej 840,00 €
- d. për shpenzimet e mjekimit shumën prej 2.317,00 €
- e. për fitimin e humbur në formë të rentës së kapitalizuar për periudhën 06.11.2011 deri më 30.11.2014, shumën prej 11.224,63 €, ndërsa në të ardhmen rentën mujore nga dt.01.12.2014, tutje për secilin muaj nga 315.83 €, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore respektivisht deri paditësi të mbush moshën 65 vjet, 25.02.2031.

- **Paditësve Hatushe Veliu, Ariana Veliu, Alvin Veliu dhe Diana Veliu**

a. në emër të dhimbjeve shpirtërore secilit veç e veç shumën nga 3.500,00 €

**III REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditësve mbi shumat e aprovuara në pikën **II** të dispozitivit dhe atë:

- **Paditësit Kadri Veliu**

**1. Në emër të dëmit jo material**

a. për frike të pësuar shumën prej 5.900,00 €;

b. për dhimbje trupore-fizike shumën prej 7700,00 €;

c. për shëmtim trupor shumën prej 1.500,00 €;

d. në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej 10.250,00 €

**2. Në emër të dëmit material,**

a. për rehabilitim-terapi fizikale shumën prej 3.660,00 €.

- **Paditësve Hatushe Veliu, Ariana Veliu, Alvin Veliu dhe Diana Veliu**

a. në emër të dhimbjeve shpirtërore secilit veç e veç shumën nga 1.500,00 €.

**IV OBLIGOHET** e paditura që paditësve të i paguaj shumat e cekura në pikën **II**, të dispozitivit, në shumë të përgjithshme prej 62.881,63€ € (gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind tetëdhjete e një euro e gjashtëdhjetë e tre cent), të gjitha me kamatën ligjore prej 12%, të përcaktuar sipas Ligjit për Sigurime të detyrueshme nga auto përgjegjësia nr. 04/L-018, nga data 29.12.2011, deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë pre 4.967,00 € të gjitha në afat prej 15 ditë, pas marrjes së formës së prerë të aktgjyqimit në kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Obligohet paditësi që të paguaj taksen gjyqësore për padi dhe aktgjykim në shumë prej 414.00 €”.

15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit e kërkesës dhe kompania e sigurimeve “Sigal” parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjyqimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që aktgjykimi i kontestuar të ndryshohet ose të priset dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.
16. Më 27 prill 2020, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin [Ac. nr. 4145/15] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve të kërkesës, ndërsa ankesën e kompanisë së sigurimeve “Sigal” e pranoi pjesërisht duke e anuluar dhe ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Në pjesën përkatëse të dispozitivit të aktgjyqimit, Gjykata e Apelit theksoi,

“**NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C. Nr .675/11 i datës 07.08.2015, sa i përket kërkesës për dëmin jomaterial për frikën e pësuar, dhe gjykohet si vijon: **APROVOHET** pjesërisht kërkesa e paditësit Kadri Veliu, **OBLIGOHET** e paditura Kompania e Sigurimeve „SIGAL“, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të frikës së përjetuar t’i paguajë shumën 5.500,00 € (pesëmijë e pesëqind euro), **REFUZOHET** kërkesa e paditësit mbi shumën e gjykuar në

*emër të dëmit jo material: për frikën e përjetuar, në shumën prej 1.500,00 € (një mijë e pesëqind euro), si e pabazuar”.*

17. Në një datë të pacaktuar, “Sigal” parashtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
18. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit e kërkesës dorëzuan përgjigje në revizionin e kompanisë së sigurimeve “Sigal”.
19. Më 12 prill 2020, Gjykata Supreme me Aktgjykimin [E. Rev. nr. 427/2020], (i) refuzoi, si të pabazuar, revizionin e kompanisë së sigurimeve “Sigal”, dhe (ii) aprovoi revizionin si të bazuar në lidhje me kamatëvonesën, si dhe detyroi kompaninë e sigurimeve “Sigal” që shumat e gjykuara, t’ua paguaj paditësve me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data 7.08.2015, si datë e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë e deri në pagesën definitive. Në kuadër të kësaj të fundit, Gjykata Supreme ndër të tjera arsyetoi:

*“Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se përkitazi me caktimin e kamatës, aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, ndaj, lidhur me kamatën, kjo gjykatë i ndryshojë aktgjykimet e sipër përmendura, duke vendosur si në pjesën e II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Kështu, për faktin sepse, sikundër rezulton edhe nga shkresat e lëndës, pala paditëse nuk ka provuar dhe argumentuar me fakte se kur e ka paraqitur kërkesën për dëmshpërblim tek e paditura dhe nëse e paditura nuk e ka trajtuar të njëjtën siq kërkohet me dispozita ligjore.*

*Me fjalë të tjera, pala paditëse nuk ka vërtetuar se kërkesa përkatëse i është dërguar së paditurës në mënyrë ligjore, nuk ka as datë të pranimit nga ana e saj, nuk ka as nënshkrim të pranimit të saj, e as vulë të pranimit të kërkesës. Nga këtu, nuk rrjedh se janë plotësuar kushtet e parapara shprehimisht me dispozitat e nenit 26 par.1, par.6 dhe par. 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, për caktimin e kamatës në lartësi prej 12%, sikundër gabimishtë, në aktgjykimet e tyre, kishin vendosur gjykatat e instancës më të ulët”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar është marrë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e tyre themelore të përcaktuara në nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të GJEDNJ-së.
21. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës pretendojnë, “arësyetim i Gjykatës Supreme të Kosovës nuk qëndron, e këtë e vërteton dëshmia se parashtruesi i kërkesës te e paditura me datë 11.01.2012. ka dorëzuar kërkesën për dëmshpërblim që e dëshmon nënshkrimi i Zyrtares ligjore të së paditurës dhe se në përmbajtjen e kërkesës për dëmshpërblim është kërkuar edhe paradhënie

në shumën prej 5,000.00 € si pjesë jokontestuese për paditësin Kadri Veliu, pasiqë i njëjti për shkak të lëndimeve të rënda trupore, ka pasur nevojë për kurim të vazhdueshëm mjekësor por që gjendja e tij e rëndë financiare në familjen e tij, nuk ka mundësuar mbulimin e shpenzimeve të trajtimit mjekësor dhe për më tepër ky fakt pranohet edhe nga vet e paditura në Revizionin e saj të datës 05.06.2020, te pjesa "kundërshtimet në lidhje me kamatën ligjore", pasuesi i dytë ku ka theksuar se: "e paditura në afatin e parapaparë ligjor iu ka përgjigjur palës së dëmtuar duke iu ofruar ofertë, por këtë nuk e ka argumentuar me provë (nuk ka njoftim me shkrim për oferte eventuale e as për paradhënie) por ajo që është me rëndësi këtu, se e paditura vërteton faktin e pranimit të kërkesës së paditësit për dëmshpërblim, fakt ky që e bënë të paqëndrueshëm arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me këtë rast".

22. Parashtruesit e kërkesës e lidhin pretendimin për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së me zbatimin e gabuar të ligjit, duke theksuar se,

*"Meqenëse e paditura ka pranuar kërkesën për dëmshpërblim nga paditësi Kadri Veliu (por pranimi i kërkesës është bërë duke shënuar datën e pranimit dhe nënshkrimi i Zyrtares ligjore ashtu siç është praktikë e kompanive të sigurimit për metodën e pranimit të kërkesave e kjo metodë e pranimit mund të vërtetohet në çdo kohë se dorëzimi i kërkesës nuk është kontestuese), por që nuk iu ka përgjigjur sipas afateve të përcaktuara me nenin 26 par. 1, par. 4 e par. 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, në fakt ka vepruar në kundërshtim të plotë me këtë dispozitë ligjore, duke e dëmtuar kështu parashtruesin e kërkesës në mosdhënien e pjesës jokontestuese, e cila ka qenë e domosdoshme për shërimin e tij nga pasoja e aksidentit e që në mungesë të mjeteve financiare këtij paditësi iu ka pamundësuar që të bëjë shërim adekuat dhe efikas mjekësor nga pasojat e aksidentit, ashtuqë për këtë shkak edhe sot e kësaj dite vuan nga pasojat e aksidentit".*

23. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit, "nuk janë të përfshira me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkundrazi kanë vepruar saktë dhe drejtë në zbatim të së drejtës materiale dhe në harmoni të plotë me dispozitat e cekura ligjore lidhur me caktimin e lartësisë së kamatës;

*Ndërkaq që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës me numër e datë të cekur është nxjerrë në shkelje të nenit 24, 31, lidhur me nenin 6 të Kushtetutës duke i dëmtuar kështu padrejtësisht parashtruesit e kërkesës. E kjo duke pasë parasysh faktet dhe provat e cekura më lartë rezulton se arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për ndryshimin të kamatës është i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e cekura ligjore me të cilin në zbatim eventuale të tij, parashtruesit e kërkesës do të dëmtohen kundërligjshëm dhe në mënyrë të konsiderueshme që gjithsesi do të ndikoj në përkeqësimin edhe ashtu të rëndë të gjendjes financiare të kësaj familje."*

24. Lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës, përveç përmendjes së këtij neni, nuk elaborojnë më tej se si dhe pse u janë shkelur të drejtat e garantuara me këto nene të Kushtetutës.

25. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata, “Anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme për ndryshimin e lartësisë së kamatës dhe vërtetimi i aktgjytimeve të instancave më të ulta”.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

26. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

28. Në vijim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat tjera të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

#### **Neni 47 [Kërkesa individuale]**

- 1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
- 2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

#### **Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]**

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

#### **Neni 49 [Afatet]**

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.*

29. Lidhur me plotësimin e kushteve të tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj dhe të parashtruara më lart, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar që kontestojnë aktin e autoritetit publik, përkatësisht aktgjykimin [Rev. nr. 427/2020] e Gjykatës Supreme të 12 prillit 2021, pasi kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit po ashtu theksuan të drejtat dhe liritë

themelore që ata pretendojnë se u janë shkelur në pajtim me kushtet e nenit 48 të Ligjit dhe e parashtruan kërkesën e tyre në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

30. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, konkretisht rregullat 39 (1) (d) dhe (2) të cilat përcaktojnë:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese*

*[...]*

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

31. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë gjykata nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuzë dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës*, kërkesa nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 4241/03, kategoria (iii)).

32. Gjykata rikujton rrethanat e rastit, konkretisht, aksidentin e trafikut në vitin 2011. I njëjti është shkaktuar nga i siguruari i kompanisë së sigurimit “Sigal”, ndërsa parashtruesit e kërkesës kanë pësuar dëme materiale dhe jomateriale. Gjykata po ashtu thekson se sipas parashtruesit të kërkesës më 11 janar 2012



është kërkuar parapagimi përkatës nga kompania e sigurimeve “Sigal”, mirëpo në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se kërkesa përkatëse i është dërguar ligjërisht kompanisë së sigurimit “Sigal”, gjegjësisht procedura për realizimin e kërkesave (kompensimi i dëmit) nuk ishte iniciuar asnjëherë te e njëjta. Më 28 dhjetor 2011, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në Gjykatën Themelore. Kërkesa për kompensim të dëmit është aprovuar në Gjykatën Themelore dhe është përcaktuar kamatëvonesa në shumën prej 12%, duke filluar nga 28 dhjetor 2011 deri në pagesën përfundimtare. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore me aktgjykimin e saj [C. nr. 675/11] të 7 gushtit 2015, arsyetoi caktimin e kamatëvonesës prej 12% në bazë të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm.

33. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4145/15], të 27.04.2020, aprovoi pjesërisht ankesën e kompanisë së sigurimit “Sigal”, dhe ndryshoi aktgjykimin (C. nr. 675/11) të Gjykatës Themelore të 7 gushtit 2015, vetëm në pjesën që lidhet me kërkesën e parashtruesve për kompensimin e dëmit jomaterial, ndërsa në pjesën tjetër Gjykata e Apelit e vërtetoi në tërësi aktgjykimin e shkallës së parë. Për rrjedhojë, kompania e sigurimeve “Sigal” parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke kontestuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, konkretisht shumën e caktuar në emër të dëmit jomaterial, si dhe pjesën e aktgjykimit që ka të bëjë me kamatëvonesën. Me atë rast, Gjykata Supreme me aktgjykimin [Rev. nr. 427/2020] të 12 prillit 2021, refuzoi revizionin e kompanisë së sigurimit “Sigal” në pjesën që ka të bëjë me lartësinë e shumës së caktuar në emër të dëmit jomaterial si. të pabazuar, ndërsa pjesën e revizionit që ka të bëjë me kamatëvonesën, Gjykata Supreme aprovoi dhe ndryshoi aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë. Në pjesën përkatëse të dispozitivit, Gjykata Supreme theksoi se, *“PRANOHET revizioni i së paditurës vetëm përkitazi me kamatën e aprovuar, ashtu që në këtë pjesë të dy aktgjykimet, ai i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë C. nr. 675/11 dt.7.08.2015, NDRYSHOHEN dhe detyrohet e paditura që shumat e gjykuara, t’ua paguaj paditësve me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data 7.08.2015, si datë e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë e deri në pagesën definitive.*
34. Parashtruesit e kërkesës i kontestojnë konstatimet e mësipërme të Gjykatës Supreme, duke pretenduar se aktgjykimi i kontestuar është përfshirë në shkelje të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata rikujton se lidhur me pretendimin e tyre për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës pretendojnë mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe gjendjen faktike të vërtetuar gabimisht të Gjykatës Supreme.
35. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të së drejtës për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës.
36. Gjykata do të shqyrtojë këto dy kategori të pretendimeve, përkatësisht pretendimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për shkelje të së drejtës për barazi para ligjit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas së cilës, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe

liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Në vazhdim, Gjykata do të vazhdojë t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe më pas do të vazhdojë t'i shqyrtojë pretendimet në lidhje me të drejtën për barazi para ligjit.

**I. *Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së***

*Lidhur me pretendimet për mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor*

37. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës, në kontekst të pretendimit të tyre për mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor, konsiderojnë se aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme i mungon arsytimi adekuat për shkak se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe rrjedhimisht, janë interpretuar gabimisht paragrafët 1, 4 dhe 6 të nenit 26 të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm.
38. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës specifikon se *“[...] arësytim i Gjykatës Supreme të Kosovës nuk qëndron, e këtë e vërteton dëshmia se parashtruesi i kërkesës te e paditura me datë 11.01.2012. ka dorëzuar kërkesën për dëmshpërblim që e dëshmon nënshkrimi i Zyrtares ligjore të së paditurës dhe se në përmbajtjen e kërkesës për dëmshpërblim është kërkuar edhe paradhënie në shumën prej 5,000.00 € si pjesë jokontestuese për paditësin Kadri Veliu, pasi që i njëjti për shkak të lëndimeve të rënda trupore, ka pasur nevojë për kurim të vazhdueshëm mjekësor por që gjendja e tij e rëndë financiare në familjen e tij, nuk ka mundësuar mbulimin e shpenzimeve të trajtimit mjekësor dhe për më tepër ky fakt pranohet edhe nga vet e paditura në Revizionin e saj të datës 05.06.2020, te pjesa "kundërshtimet në lidhje me kamatën ligjore", pasuesi i dytë ku ka theksuar se: “e paditura në afatin e paraparë ligjor iu ka përgjigjur palës së dëmtuar duke iu ofruar ofertë, por këtë nuk e ka argumentuar me provë (nuk ka njoftim me shkrim për oferte eventuale e as për paradhënie) por ajo që është me rëndësi këtu, se e paditura vërteton faktin e pranimit të kërkesës së paditësit për dëmshpërblim, fakt ky që e bënë të paqëndrueshëm arsytimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me këtë rast”.*
39. Rrjedhimisht, bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës, edhe pse ngritën çështjen e vendimit të paarsyetuar, në thelb në lidhje me dispozitat e nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, pretendojnë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e Gjykatës Supreme.
40. Për këtë arsye, Gjykata, në bazë të përmbajtjes së pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, do të vlerësojë nëse pretendimet për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të ligjit bien në sferën e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë.
41. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe theksoi

se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (Shih: në këtë kontekst dhe, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, “Adem Jashari”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).

42. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (Shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe shih gjithashtu rastet KI128/18, të cituara më sipër, paragrafi 56; dhe KI62/19, të cituar më lart, paragrafi 58).
43. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme konstatoi se kompania e sigurimeve “Sigal” kërkesën e saj për revizion e parashtrroi kundër aktgjykimit [Ac. nr. 4145/15] të Gjykatës së Apelit të 27 prillit 2020. Gjithashtu, Gjykata rikujton se në kërkesën e saj për revizion, kompania e sigurimeve “Sigal”, ka pretenduar interpretim dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë me rastin e caktimit të shumës së kamatëvonesës, përkatësisht datës nga e cila llogaritet kamata.
44. Gjykata vëren se Gjykata Supreme aprovoi pjesërisht revizionin e kompanisë së sigurimeve “Sigal” dhe konstatoi si në vijim:

*“sikundër rezulton edhe nga shkresat e lëndës, pala paditëse nuk ka provuar dhe argumentuar me fakte se kur e ka paraqitur kërkesën për dëmshpërblim tek e paditura dhe nëse e paditura nuk e ka trajtuar të njëjtën siq kërkohet me dispozita ligjore.*

*Me fjalë të tjera, pala paditëse nuk ka vërtetuar se kërkesa përkatëse i është dërguar së paditurës në mënyrë ligjore, nuk ka as datë të pranimit nga ana e saj, nuk ka as nënshkrim të pranimit të saj, e as vulë të pranimit të kërkesës. Nga këtu, nuk rrjedh se janë plotësuar kushtet e parapara shprehimisht me dispozitat e nenit 26 par.1, par.6 dhe par. 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, për caktimin e kamatës në lartësi prej 12%, sikundër gabimishtë, në aktgjykimet e tyre, kishin vendosur gjykatat e instancës më të ulët”.*

45. Në kontekst të arsyetimit të Gjykatës Supreme, Gjykata i referohet nenit 26 të LIGJIT NR. 04/L-018 PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTO-PËRGJEGJËSIA, i cili përcakton:

*“1. Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjastëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në*

*afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me:*

*1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse;*

*1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.*

*2. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për dëmshpërblimin, siguruesi është i detyruar që, më së largu në afat prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin duke precizuar me cilat nga provat dhe dokumentacioni duhet plotësuar kërkesën. Prej ditës së pranimit, respektivisht kompletimit të dokumentacionit të kërkesës, fillojnë të zbatohen afatet nga paragrafi 1. i këtij neni për detyrimin e siguruesit përkitazi me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.*

*[...]*

*4. Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguajë palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni.*

*[...]*

*6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. [...]*

46. Në dritën e sa më sipër, Gjykata rithekson se Gjykata Kushtetuese mund të vlerësojë interpretimet ligjore të gjykatave të rregullta në raste të jashtëzakonshme dhe vetëm nëse ato interpretime janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih, rastin e cituar më lart të Gjykatës, KI128/18, paragrafi 59).
47. Megjithatë, në bazë të lartcekurave, si dhe në interpretimin dhe arsyetimin e dhënë nga Gjykata Supreme, në rastin konkret nuk është dëshmuar se ka arbitraritet në interpretimin e dhënë nga Gjykata Supreme me rastin e pranimit të revizionit të kompanisë së sigurimeve “Sigal” në pjesën që ka të bëjë me caktimin e normës së interesit.
48. Gjykata gjithashtu thekson se parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre theksojnë se ka ekzistuar kërkesa e tyre në kompaninë e sigurimeve “Sigal”, megjithatë, Gjykata Supreme thekson se nuk ka dëshmi se kërkesa përkatëse është dërguar ligjërisht, përkatësisht regjistruar.

49. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, nr. 04/L-018, neni 1 përcakton se: *“Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar”*. Megjithatë, Gjykata rikujton përsëri se Gjykata Supreme e ka bazuar arsyetimin e saj për pranimin e revizionit dhe ndryshimin e pjesës së aktgjykimit në lidhje me shumën dhe datën e llogaritjes së kamatës, konkretisht në bazë të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, nr. 04/L-018, me dispozitën e të cilit përcaktohet: *“Prej ditës së pranimit, respektivisht kompletimit të dokumentacionit të kërkesës, fillojnë të zbatohen afatet nga paragrafi 1. i këtij neni për detyrimin e siguruesit përkitazi me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim”*.
50. Prandaj, në rrethanat e rastit në fjalë, Gjykata rithekson se parashtruesit e kërkesës, përveç pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i vendimit të paarsyetuar të Gjykatës Supreme lidhur me interpretimin dhe zbatimin e Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, nr. 04/L-018, nuk ka vërtetuar apo argumentuar mjaftueshëm para Gjykatës se si ky interpretim i *“dispozitave ligjore” nga Gjykata Supreme, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”* duke rezultuar në konkluzione *“arbitrare”* ose *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin e kërkesës apo se si procedura në Gjykatën Supreme mund të mos ketë qenë e drejtë apo edhe arbitrare.
51. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi në kërkesën e tij nuk arriti të dëshmojë dhe argumentojë pretendimin e tij se Gjykata Supreme me rastin e interpretimit dhe zbatimit të së drejtës materiale, përkatësisht dispozitave të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, nr. 04/L-018, ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht, ky pretendim i parashtruesit të kërkesës hyn në kategorinë (iii), nënkategoria (b) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*, dhe si i tillë, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

## **II. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës**

52. Sa i përket shkeljeve të të drejtave të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata rikujton edhe një herë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) (d) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (1) (d) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë kriterin që kërkesa nuk është qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (1) (d) thekson se:

### **Rregulli 39 (Kriteret e pranueshmërisë)**

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese

53. Gjykata rikujton se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe në paragrafët (1) (d) të rregullit 39 të Rregullores së punës, si dhe në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka theksuar vazhdimisht se: (i) palët janë të detyruara të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe të mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave ose dispozitave kushtetuese.
54. Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës thjesht pretendojnë shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, por parashtruesit më tutje nuk ofrojnë arsyetim të detajuar se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni. Gjykata rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi i thjeshtë i neneve të Kushtetutës dhe KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk mjafton për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të ofrojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81, KI166/20, cituar më lart, paragrafi 52, KI 04/21 cituar më lart, paragrafët 38-39).
55. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës, të njëjtat hyjnë në kategorinë (iii), nënkategoria (b) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara, siç përcaktohet në paragrafin (1) (d) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

## **Përfundim**

56. Si përmbledhje, Gjykata, duke marrë parasysh elaborimet dhe konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin që:
- i. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së hyjnë në kategorinë (iii), pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, nënkategoria (b), dhe si të tilla, të njëjtat në baza kushtetuese duhet të shpallen si qartazi të pabazuara;
  - ii. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, hyjnë në kategorinë (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, nënkategoria (a), dhe si të tilla, dhe si të tilla, të njëjtat në baza kushtetuese duhet të shpallen si qartazi të pabazuara.
57. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (d) dhe (2), më 12 maj 2022, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Bajram Ljatifi

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani

